

PROCESVERBAL
nga seanca e 9-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale,
mbajtur më 8.3.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencië nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, dr.Metodija Jançeski, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski .

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishmit nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video konferencë: Cvetanka Mitrevska, mr.Emilija Janevska,Goran Radunoviq, mr.Arben Saiti, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski hapi seancën e 9-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:30 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 8-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e mbajtur më 27.2.2023.
2. Propozim - vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit radiodifuziv jofitimprurës, në nivel rajonal, në zonën e rajonit të Shkupit, me Propozim - Dokumentacionin e Konkursit dhe Propozim – Aplikim.
3. Propozim - vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit transmetues jofitimprurës në nivel lokal, në zonën e komunës së Tetovës, me Propozim - Dokumentacionin e Konkursit dhe Propozim – Aplikim.
4. Propozimet për fillimin e procedurës për heqjen e lejes për TV dhe transmetim në radio të transmetuesve.
5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP për shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV.

6. Propozim për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për punën juridike, financiare dhe ekonomike .
7. Propozim për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Softuer për mbrojtjen dhe parandalimin e kompjuterëve personal dhe serverëve.
8. Propozim për ndryshimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.
9. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e seancës së 8-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 27.2.2023, me tekstin e propozuar.

Pikat 2 dhe 3

Z. Trajçevski njoftoi se do të bëjë një hyrje në dy pikat, përkatësisht për Propozim - vendimet për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit radiodifuziv jofitimprurës, në nivel rajonal, në zonën e rajonit të Shkupit dhe në nivel lokal, në zonën e komunës së Tetovës, me Propozim – Dokumentacionin e Konkursit dhe Propozim - Aplikim. Ai shpjegoi se disa muaj para vitit të ri, ka shprehur interes institucioni privat i arsimit të lartë Universiteti për Turizëm dhe Menaxhim në Shkup për marrjen e lejes për transmetim në radio për radion studentore jofitimprurëse për territorin e qytetit të Shkupit. Pak më vonë për herë të tretë shfaqti interes edhe Universiteti Shtetëror nga Tetova. Ndërkohë, pas kërkesave të dorëzuara zyrtarisht nga dy universitetet, ASHMA-ja iu drejtua Agjencisë së Komunikimeve Elektronike për të marrë informacion nëse ka frekuenca të lira. Pas marrjes së përgjigjes zyrtare pozitive nga AKE-ja se ka frekuenca të lira, u përgatit një Studim për arsyetimin e shpalljes së Konkursit (tenderit) publik, i cili rezultoi se në të dyja rastet ka arsyetim, duke qenë se bëhet fjalë për radiot jofitimprurëse që minimalisht ose aspak nuk do të ndikojnë në radiot e tjera komerciale që funksionojnë në zonën e rajonit të Shkupit dhe lokalisht në zonën e komunës së Tetovës. Për këtë arsye, propozohet shpallja e konkursit publik për dhënien e dy lejeve për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit transmetues jofitimprurës për vendet e përmendura.

Z. Petrushevski, meqenëse drejtori bëri hyrje dhe i sqaroi të dy pikat, sugjeroi që pyetjet dhe diskutimet të bëhen për dy propozim-vendimet dhe votimi të bëhet për secilën pikë individualisht.

Z. Ajdini tha se çdo gjë që ishte e rëndësishme për vendimet e propozuara është shpjeguar nga drejtori. Ai tha se është mirë që ka palë të interesuara për hapjen e radios jofitimprurëse për rajonin e qytetit të Shkupit dhe për komunën e Tetovës. Është e rëndësishme që gjetjet nga Studimi i përgatitur kanë treguar se ka arsyetim për shpalljen e dy konkurseve në nivel lokal dhe rajonal. Në atë drejtim, dhe nga AKE është marrë përgjigje pozitive se ka frekuenca të lira për të dyja kërkesat. Ai shpjegoi se dëshiron të japë një propozim lidhur me kërkesën për radiot jofitimprurëse nga Universiteti i Tetovës, dhe duke pasur parasysh se universitetet nuk janë në gjendje shumë të favorshme financiare, ka

sugjeruar që të ndryshohet, përkatësisht dokumentacioni i konkursit që duhet të mirret dhe që është në vlerë prej 60.000,00 denarë, i njëjti të përgjysmohet dhe të jetë 30.000,00 denarë për të dy universitetet. Ai beson se ky propozim nëse miratohet do t'i përmbushë dhe do t'i ndihmojë financiarisht.

Z. Trajçevski pyeti udhëheqësit e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike dhe Sektorin për çështje ekonomike, nëse ASHMA-ja ka sjellë ndonjë akt në periudhën e kaluar lidhur me shumën prej 60.000,00 denarë për marrjen (ngritjen) e dokumentacionit të tenderit sepse kjo shumë është paguar për një kohë të gjatë kur shpallet konkursi publik apo ato mjete (fonde) përcaktohen me vendim të Këshillit kur ai miraton shpallje të konkursi publik për dhënien e lejes?

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska sqaroi se ASHMA-ja nuk ka miratuar akt të veçantë dhe kjo shumë për ngritjen e dokumentacionit përcaktohet nga vetë dokumentacioni i tenderit.

Pas shpjegimit, Z. Petrushevski e pyeti drejtorin nëse është dakord me propozimin e z. Ajdini?

Z. Trajçevski u përgjigj, duke pasur parasysh faktin se Universiteti i Tetovës dy herë ka paraqitur kërkesë dhe dy herë ka ngritur (tërhequr) dokumentacion tenderi dhe ka paguar nga 60.000,00 denarë, ndërsa konkursi nuk u realizua, ai ka propozuar për të dy pikat pra Pika 2 dhe Pika 3 për këtë konkurs konkretisht kompensimi duhet të jetë 30.000,00 denarë, sigurisht nëse Këshilli jep miratim.

Z. Petrushevski tha se personalisht është dakord sepse bëhet fjalë për radio studentore dhe në këtë kohë krize do të ishte mirë të bëhet përjashtim, por tha se nuk duhet të mbetet si rregull për të ardhmen.

Z. Fidanoski deklaroi se do të mbështesë përgjysmimin e shumës aktuale të ngarkuar për marrjen e dokumentacionit të tenderit. Për Shkupin, ai tha se nuk dihet se kush do të aplikojë në konkursin për radio jofitimprurëse, ndonëse kërkesën e ka paraqitur Universiteti për Turizëm dhe Menaxhim në Shkup. Ai konsideron se në këto momente krize shuma prej 30.000,00 denarë është adekuate. Gjithashtu, shërbimi i Agjencisë u jep udhëzime palëve të interesuarve që në mënyrë të rregullt (pra saktë) të plotësojnë dokumentacionin që të mund të konkurojnë (aplikojnë) për marrjen e lejes së specifikuar.

Z. Petrushevski, pas diskutimeve që u zhvilluan për pikat konstatoi se shumica prej tyre kanë deklaruar se është e pranueshme që të ketë korigjime në dy propozim-vendimet për ngritjen e dokumentacionit në vlerë prej 30.000,00 denarë. Këshilli nuk kishte asnjë kundërshtim.

Votimi për pikën 2

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për shpallje të konkursi publik për dhënien e 1 (një) leje për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit transmetues jofitimprurës në nivel rajonal, destinuar për popullatën studentore, zona e shpërndarjes D1 Crn Vr - zona e nivelit rajonal të Shkupit (qyteti i Shkupit dhe komunat Çučer Sandevë, Haraçinovë, Ilinden, Petrovec, Zelenikovë, Studeniçan dhe Sopishte), në gjuhën maqedonase, e cila do të transmetohet nëpërmjet radiofrekuencës përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike e RMV-së, përkatësisht: 106 . 5 M Hz , me Dokumentacion

konkursi (tenderi) për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit transmetues jofitimprurës, në nivel rajonal, në zonën e qytetit të Shkupit dhe Aplikimi për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit radiodifuziv jofitimprurës në nivel rajonal, në zonën e qytetit të Shkupit .

Shpenzimet e bëra nga aplikanti për përgatitjen dhe dorëzimin e aplikacionit për pjesëmarrje në konkursin publik dhe dokumentacionit shoqërues do të mbulohen nga aplikanti, përkatësisht për dokumentacionin paguhet kompensim në shumë prej 30.000,00 denarë në xhiro llogarinë: 300000000618023, të Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Banka depozituese: Banka Komerciale SHA Shkup.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e lartpërmendur ta publikon në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, si dhe së paku në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësive joshumicë, por që e flasin së paku 2% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut , dhe hyn në fuqi nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendimin për shpalljen e konkursit publik për dhënien e 1 (një) leje për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit transmetues jofitimprurës të destinuar për popullatën studentore, në nivel lokal, në zonën e komunës së Tetovës, në gjuhën shqipe dhe maqedonase, e cila do të transmetohet nëpërmjet radiofrekuencës së përcaktuar nga Agjencia për Komunikim Elektronik të RMV-së, përkatësisht: 107.2 MHz, me dokumentacion konkursi për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit radiodifuziv jofitimprurës, në nivel lokal, në zonën e komunës së Tetovës dhe Aplikim për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbim programor të institucionit transmetues jofitimprurës në nivel lokal, në zonën e komunës së Tetovës.

Shpenzimet e bëra nga aplikanti për përgatitjen dhe dorëzimin e aplikacionit për pjesëmarrje në konkursin publik dhe dokumentacioni shoqërues do të mbulohen nga aplikanti, përkatësisht për dokumentacionin paguhet kompensim në shumë prej 30.000,00 denarë në xhiro llogarinë: 300000000618023, të Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Banka depozituese: Banka komerciale SHA Shkup.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e lartpërmendur ta publikon në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, dhe së paku në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe hyn në fuqi nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Z. Petrushevski pas votimit sqaroi se konkursi është i hapur për të gjithë palët e interesuara dhe nuk do të thotë se do të aplikojnë vetëm dy universitetet. Është e rëndësishme që konkursi të përfundojë me sukses.

Pika 4

Z. Petrushevski, në lidhje me Propozimet për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes për TV dhe transmetim në radio të radiodifuzerëve, sqaroi se në rend dite janë propozime për 14 transmetues dhe baza për të gjithë është e njëjtë, përkatësisht për pagesë me vonesë të shumës për kompensim vjetor të lejeve. Ai sugjeroi që të gjithë të kenë diskutim të përbashkët dhe më pas të votohet për secilin propozim individualisht.

Z. Trajçevski sqaroi se për të 14 transmetuesit, fatura e dhënë (lëshuar) për pagesën e kompensimit për transmetim në televizion dhe radio është zvogëluar për 25% sipas vendimit të Këshillit. Të 14 transmetuesit tërësisht ose pjesërisht nuk e kanë paguar kompensimin. Materialet janë dorëzuar sipas të dhënave të datës 6 mars. Gjatë ditës së djeshme ka pasur pagesë nga RA Metropolis dhe RA 5 ÇOKI nga Prilepi, por jo në tërësi sepse ende kanë borxh një shumë të caktuar, gjegjësisht nuk e kanë paguar faturën e lëshuar në tërësi. Për këtë arsye, për të 14 transmetuesit propozohet që të fillojë procedurë për heqjen e lejes.

Z. Petrushevski tha se të gjitha 14 propozimet do t'i vë në votim dhe shpreson ende se transmetuesit do të gjejnë mjete brenda afatit ligjor për të paguar kompensimin.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri inicioi procedurën për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive ARAÇINA SHPKNJP f.Haraçinë, Haraçinë, nr.08-67, datë 5.1.2015, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184. /13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 42/20 dhe 77/21) .

Në pajtim me Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr. 05-1003/1 datë 3.3.2023, transmetuesi nuk ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht nuk ka paguar kompensim vjetor për lejen e transmetimit në radio ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetore për leje sipas faturës së lëshuar nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive ARAÇINA SHPKNJP f.Haraçinë, Haraçinë, nr.08-67 datë 5.1.2015 .

- Këshilli i Agjencisë njëzëri inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetimin në radio Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO LA KOSTA SHPKNJP Vinicë, nr 08-93 datë 5.1.2015, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14. , 132 / 14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 42/20 dhe 77/21) .

Në pajtim me Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr. 05-1002/1 datë 3.3.2023, transmetuesi nuk ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht nuk ka paguar kompensim vjetor për lejen e transmetimit në radio ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes sipas faturës së lëshuar nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh

nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO LA KOSTA SHPKNJP Vinicë, nr 08-93 nga 5.1.2015.

Këshilli i Agjencisë njëzëri inicioi procedurën për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101. /14 , 132 /14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 42/20 dhe 77/21) .

Sipas Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr. 05-1001/1 datë 3.3.2023, transmetuesi nuk ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, përkatësisht nuk ka paguar kompensim vjetor për lejen për transmetim në radio ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetore për leje sipas faturës së lëshuar nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO 5 ÇOKI SHPKNJP Prilep .

- Këshilli i Agjencisë njëzëri inicioi procedurën për heqjen e lejes për transmetim në televizion ndaj Shoqërisë Tregtare me Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, nr.08-18, datë 5.1.2015, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.184 /13, 13/14, 44/14, 101/14 , 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 42/20 dhe 77/21) .

Sipas Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr. 05-1000/1 datë 3.3.2023, transmetuesi nuk ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, gjegjësisht nuk ka paguar kompensim vjetor për lejen për transmetim në televizion ndaj Agjenciasë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan tarifën vjetore të lejes sipas faturës së lëshuar nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në televizion ndaj Shoqërisë tregtare për veprimtari radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, nr.08-18 datë 5.1.2015.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri inicioi procedurën për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, nr.08-64, datë 5.1.2015, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.184/13,13/14,44/14, 101/14,132/14,142/16,132/17,168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 42/20 dhe 77/21) .

Sipas Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr. 05-998 / 1 datë 3.3.2023, transmetuesi nuk ka plotësuar detyrimin nga 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuele, gjegjësisht nuk ka paguar kompensim vjetor për lejen e transmetimit në radio ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan kompensimin vjetor të lejes sipas faturës së lëshuar nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për marrjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, nr 08-64 datë 5.1.2015.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri inicoi procedurën për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, nr.08-65, 5.1.2015, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14, 44/ 14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 42/20 dhe 77/21).

Në pajtim me Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr.05-997/1 datë 3.3.2023, transmetuesi nuk e ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensim vjetor për transmetim në radio ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor për leje sipas faturës së lëshuar nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjes e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, nr 08-65 datë 5.1.2015.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri inicoi procedurën për heqjen e lejes për transmetim në television ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV ERA SHPKNJP Shkup, nr.08-15, datë 5.1.2015, për shkelje të 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë",nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 42/20 dhe 77/21).

Sipas Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr. 05-1023/1 datë 6.3.2023, transmetuesi nuk e ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensim vjetor për lejen për transmetim televiziv ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin vjetor të lejes sipas faturës së lëshuar nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV ERA SHPKNJP Shkup, nr 08-15 datë 5.1.2015.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri inicoi procedurën për heqjen e lejes për transmetim televiziv ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive T.V. KALTRINA Mazar Tateshi , Strugë SHPKNJP, nr. 08-55, datë 5.1.2015, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14, 44/ 14, 101/14 , 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 42/20 dhe 77/21) .

Në pajtim me raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr. 05-1022/1 datë 6.3.2023, transmetuesi nuk e ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për

Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e ka paguar kompensimin vjetor të lejes sipas faturës së lëshuar nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP, nr 08-55 datë 5.1.2015.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri inicoi procedurën për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë tregtare Radiodifuzive RADIO KAVADARCI SHPKNJP Kavadar, nr. 08-101 datë 5.1.2015, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14, 44/ 14, 101/14 , 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV_së" nr. 42/20 dhe 77/21).

Sipas Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr. 05-1019/1 datë 6.3.2023, transmetuesi nuk ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, gjegjësisht nuk ka paguar kompensim vjetor për leje për transmetim në radio ndaj Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan kompensimin vjetor të lejes sipas faturës së lëshuar nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO KAVADARCI SHPKNJP Kavadar, nr 08-101 datë 5.1.2015 .

- Këshilli i Agjencisë njëzëri inicoi procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv ndaj Shoqërisë Transmetuese Radiodifuzive TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin SHPKNJP, Veles,nr.08-50, datë 5.1.2015, për shkelje të 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.184 /13, 13/14, 44/14, 101/14 , 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (ZGazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 42/20 dhe 77/21) .

Sipas raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr. 05-1021/1 datë 6.3.2023, transmetuesi nuk ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, gjegjësisht nuk ka paguar kompesim vjetor për lejen për transmetim televiziv ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan kompensimet vjetore të lejes sipas faturës së lëshuar nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin SHPKNJP Veles nr.08-50 datë 5.1.2015.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri inicoi procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv ndaj Shoqërisë Tregtare me veprimtari radiodifuzive SPEKTRA, komuna e Labunishtës SHPKNJP, nr. 08-56 datë 5.1.2015, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14, 44/ 14, 101/14 , 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 42/20 dhe 77/21) .

Sipas Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr. 05-1020/1 datë 6.3.2023, transmetuesi nuk ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përkatësisht nuk ka paguar kompensim vjetor për lejen për transmetim televiziv ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk i paguan kompensimet vjetore të lejes sipas faturës së lëshuar nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv ndaj Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive SPEKTRA, komuna e Labunishtës SHPKNJP, nr 08-56 datë 5.1.2015.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri inicoi procedurë për marrjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, nr. 08-133 datë 5.1.2015, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 42/20 dhe 77/21).

Në pajtim me raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr.05-1024 / 1 datë 6.3.2023, transmetuesi nuk ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensim vjetor për lejen e transmetimit në radio ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan kompensimet vjetore të lejes sipas faturës së lëshuar nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, nr 08-133 datë 5.1.2015.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri inicoi procedurën për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO MADISON SHPKNJP Kërçovë, nr.08-104 , datë 5.1.2015, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 42/20 dhe 77/21) .

Në pajtim me Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr.05-1018/1 datë 6.3.2023, transmetuesi nuk ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensim vjetor për lejen e transmetimit në radio ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan kompensimet vjetore të lejes sipas faturës së lëshuar nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO MADISON SHPKNJP Kërçovë, nr 08-104 datë 5.1.2015.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri inicoi procedurën për marrjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive GALAKSI – 2002 SHPKNJP Kavadar, nr. 08-100 datë 5.1.2015 për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe

Audiovizuele (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 42/20 dhe 77/21).

Në pajtim me Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr.05-1025/1 datë 6.3.2023, transmetuesi nuk ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, gjegjësisht nuk ka paguar kompensim vjetor për lejen për transmetim në radio ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan kompensimin vjetor të lejes sipas faturës së lëshuar nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive GALAKSI – 2002 SHPKNJP Kavadar, nr 08-100 datë 5.1.2015.

Z. Petrushevski pas votimit tha se të 14 transmetuesit duhet të njoftohen në kohë për afatin e saktë përfundimtar të pagesës së kompensimit, në mënyrë që të mos vonohen asnjë ditë dhe të humbasin lejen. Shpresohet që të gjithë transmetuesit të gjejnë fonde(financa) për të vazhduar punën.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr.Emilija Janevska,sqaroi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP per shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV. Ajo ka shpjeguar se shkelja është konstatuar nga mbikëqyrja kontrolluese e cila është kryer në shkurt të këtij viti. Ajo ka theksuar se masa e mëparshme mbi të cilën është bërë mbikëqyrja kontrolluese është shqiptuar vitin e kaluar në dhjetor. Me mbikëqyrjen kontrolluese konstatohet se transmetuesi pjesërisht ka vepruar sipas masës së shqiptuar, gjegjësisht ka mënjanuar shkeljen e nenit 92 paragrafi (3) të LSHMAAV pasi që tani ka mjaft vepra audiovizuale maqedonase në periudhën prej orës 7 deri në ora 19, por prapëseprapë është në kundërshtim me nenin 92 paragrafi (1) të LSHMAAV, sepse nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio dhe audiovizuale maqedonase gjatë ditës. Për këto arsye propozohet që sërish të shqiptohet masë vërejtje publike në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës dhe në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit, dhe të urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit programor, nr.10-695/1, datë 10.2.2023 dhe njëzëri konstatoi se ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP,t'i shqiptoi masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV sepse më 30 janar 2023 nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio dhe audiovizuale maqedonase.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, është urdhëruar që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përpilojë (hartojë) Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike, të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur duhet ta publikon në uebfaqen e Agjencisë.

Pika 6

Z. Petrushevski, në lidhje me Propozimin për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për punë juridike, financiare dhe ekonomike, sqaroi se shuma e parashikuar e mjeteve është 296.000,00 denarë, në pronësi të kodit burimor të Kompanisë për Shërbime Informative dhe Komunikuese "Gord Systems Services", ku Këshilli për këtë temë ka diskutuar në vitet e kaluara. Për këto arsye, propozimi është që shërbimi ta zbatojë procedurën me negocim.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin që Drejtori i Agjencisë të marrë vendim për furnizimin e shërbimit: Mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për punë juridike, financiare dhe ekonomike.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën (subjektin) - shërbim: Mirëmbajtje parandaluese dhe adaptive e softuerit të integruar për punë juridike, financiare dhe ekonomike është paraparë dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr. 05-4766/1 datë 23.12.2023, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

Pika 7

Z. Petrushevski, në lidhje me Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Softuer për mbrojtjen dhe parandalimin e kompjuterëve personalë dhe serverëve, sqaroi se në fakt bëhet fjalë për softuer antivirus dhe vlerën e parashikuar është 250.000,00 denarë pa TVSH .

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin që Drejtori i Agjencisë të marrë vendim për furnizimin e shërbimit: Software për mbrojtjen dhe parandalimin e kompjuterëve dhe serverëve personalë.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën - shërbim: Softueri për mbrojtjen dhe parandalimin e kompjuterëve dhe serverëve personalë është paraparë dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr. 05-4766/1 datë 23.12.2022, dhe fondet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

Pika 8

Z. Petrushevski, në lidhje me Propozimin për ndryshimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuele, sqaroi se bëhet fjalë për ndarjen lineare të 2.176,00 denarë për të punësuarit e Agjencisë. Ai shpjegoi për Rregulloren nuk japim miratim, por e sjell Këshilli.

Trajçevski shpjegoi se ndryshimet po bëhen për harmonizimin me rritjen e pagës minimale që hyri në fuqi në mars të vitit 2023, me faktin se harmonizimi në Agjenci do të bëhet në muajin prill sepse kanë kaluar 8 ditë që nga muaji mars dhe Rregullorja nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, me tekstin e propozuar.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë tekstin e rishikuar (pastruar) të Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuele.

Aktet nënligjore të mësipërme të publikohen në tabelën e shpalljeve të Agjencisë.

Pika 9

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-1007/22

13.03.2023

Shkup

**Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**